



Институт за човекови права

ZBATIMI I NJË QASJEJE TË BAZUAR  
NË TË DREJTAT E NJERIUT GJATË  
KRIZËS KOVID-19



# RAPORT MONITORIMI I ZBATIMIT TË QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT DHE KUFIZIMET QË VIJNË NGA KRIZA E KOVID-19



**USAID**  
OD AMERIKANSKIOT HAROD

**B | T | D** The Balkan Trust  
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

**RAPORTI I DYTË I MONITORIMIT PËR ZBATIMIN E QASJES BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT  
DHE KUFIZIMET QË DALIN NGA KRIZA E KOVID-19  
(PERIUDHA: SHTATOR 2021 - SHKURT 2022)**

**BOTUES:**

Instituti për të Drejtat e Njeriut

**AUTOR:**

DR VESNA STEFANOVSKA

**PËRKTHEU:**

Blerina Starova Zllatku

**VENDI DHE VITI I BOTIMIT:**

Shkup, mars 2022

*Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara, USAID-it apo Qeverisë së SHBA-së.*

# HYRJE

Në prill 2021, Instituti për të Drejtat e Njeriut filloi zbatimin e projektit “Zbatimi i qasjes të bazuar në të drejtat e njeriut gjatë krizës KOVID-19”, me mbështetjen e Fondi Ballkanik për Demokraci, një projekt i financuar nga Fondi Gjerman Marshall i Shteteve të Bashkuara dhe USAID. Qëllimi i këtij projekti është zbatimi i Qasjes së Bazuar në të Drejtat e Njeriut gjatë krizës së KOVID-19, me qëllim analizimin dhe adresimin më të mirë të kufizimeve të të drejtave të njeriut që priten të paraqiten gjatë një pandemie. Zbatimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në zbatimin e politikave shëndetësore duhet të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut në lidhje me krizën shëndetësore, si: e drejta për shëndet dhe kujdes shëndetësor, liria e lëvizjes, e drejta për arsim, e drejta për qasje në informacion, ndalimi i diskriminimit dhe të drejta të tjera të ngjashme.

## **Raporti i dytë i monitorimit është përgatitur duke mbledhur informacione si më poshtë:**

- 1) Monitorimi i aktiviteteve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të tjera të rëndësishme përmes rishikimit ditor të faqeve të tyre të internetit, monitorimit të konferencave të shtypit lidhur me Kovid-19, deklaratave dhe publikimeve;**
- 2) Paraqitja e kërkesave për qasje të lirë në informacione të karakterit publik;**
- 3) Përcjellja e informacioneve të publikuara në media që janë relevante dhe që lidhen me kufizimet në përballimin e krizës shëndetësore.**
- 4) Analizë e shkurtër e përgjigjeve të marra nga hulumtimi i kryer - Edukimi gjatë pandemisë dhe**
- 5) Analizë e Strategjisë Shëndetësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2030.**

Raporti i dytë i monitorimit të zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut dhe kufizimet që rrjedhin nga kriza e KOVID-19 do të fokusohet në të drejtën për shëndet dhe të drejtën për arsim.

Liria e lëvizjes nuk është përfshirë në këtë raport për faktin se në periudhën e përmendur nuk janë përdorur masat që kufizojnë lirinë e lëvizjes. Segmenti i fundit i analizës në këtë raport monitorimi do të jetë Strategjia Shëndetësore 2021-2030 dhe Rekomandimet për trajtimin e Kovid-19 me qëllim analizimin dhe vërtetimin nëse në krijimin e tyre është zbatuar një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut.



Drejt Ministristë së Shëndetësisë, në shkurt të vitit 2022, është dorëzuar Kërkesë për qasje të lirë në informacione, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje brenda afatit të përcaktuar me ligj. Pyetjet drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë u referohen aspekteve më të rëndësishme që lidhen me zbatimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në sigurimin e kujdesit shëndetësor, mbrojtjen e të dhënave personale dhe përfshirjen e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në dokumente, strategji dhe politika, gjegjësisht në informacione që nuk janë të disponueshme në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të cilat mund të merren vetëm me paraqitjen e një kërkesë për qasje të lirë në informacione të karakterit publik, si më poshtë:

- 1) A janë funksionale të gjitha departamentet e specializuara në spitalet e të gjithë vendit dhe a mund të kryhen pa probleme ekzaminimet dhe ndërhyrjet (incizime, operacione etj.) që nuk kanë të bëjnë me KOVID-19?**
- 2) A ka protokolle/rregulla të veçanta për mbrojtjen e të dhënave personale të pacientëve me Kovid 19?**
- 3) A kryhen kërkime dhe studime për ndikimin e krizës shëndetësore mbi ekzaminimet parandaluese dhe realizimin e kujdesit shëndetësor të kategorive të cënueshme (persona me aftësi të kufizuara, fëmijë, gra, veçanërisht nga zonat e marginalizuara)**

# A)

## E DREJTA PËR SHËNDET



**E**drejta për shëndet është një nga të drejtat themelore më të rëndësishme që vazhdon të jetë në qendër të vëmendjes në betejën kundër Kovid-19 në shtet. Zbatimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut për krijimin e politikave dhe programeve në menaxhimin e krizës së Kovid-19 është i rëndësishëm për të mbrojtur grupet më të cënueshme në shoqëri, për të ndihmuar në luftimin e përhapjes së dezinformatave dhe për të reduktuar nevojën për masa të panevojshme dhe joproportionale. Në këtë periudhë raportimi nuk është parë një numër i konsiderueshëm i masave, vendimeve apo konkluzioneve të Qeverisë lidhur me të drejtën për shëndet dhe kujdes shëndetësor. Diskutimet që zhvillohen në publik vazhdojnë të jenë të pranishme sa i përket arsyetimit rreth masave dhe mospërputhjes tyre me nevojat aktuale.

Më 17 janar 2022 u zgjodh Qeveria e re e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në përbërjen e re të Qeverisë, përveç ministrave të deriatëhershëm, janë zgjedhur edhe ministra të rinj që do të drejtojnë Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Njëkohësisht, Shtabi kryesor koordinativ i krizave të Kovid-19 do të drejtohet nga Kryeministri i ri i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Më datë 1 shkurt 2022, Komisioni për Sëmundjet Infektive mbajti mbledhje me përbërjen e re. Kryetar i ri i Komisionit është emëruar Prof. dr. Aleksandar Petliçkovski nga Instituti i Imunologjisë dhe Gjenetikës Humane, ndërsa zëdhënës i tij është emëruar dr. Zlate Mehmedoviq.<sup>1</sup>

<b>TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE LIDHUR ME KUFIZIMIN E TË DREJTËS PËR SHËNDET</b>		
<b>Llojet e publikimeve dhe institucioni që i sjell ato</b>	Vendimet dhe komunikatat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut	Konferencat e mbajtura të shtypit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Komisionit për Sëmundjet Infektive
21 vendimet dhe konkluzionet e sjella të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga 1 shtatori 2021 deri më 28 shkurt 2022, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe parandalimin e përhapjes së koronavirusit.		
<b>Informacione të tjera të publikuara</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Më 27 shtator 2021 filloi procesi i vaksinimit me dozë të tretë për profesionistët shëndetësorë, qytetarët mbi 60 vjeç dhe personat me imunitet më të ulët, tek të cilët kanë kaluar 6 muaj nga rivaksinimi.</li> <li>Më 25 nëntor 2021, Qeveria ka udhëzuar të gjitha ministrinë, ndërmarrjet publike, shoqëritë aksionare dhe agjencitë shtetërore që të bëjnë një kontroll për përcaktimin e përqindjes së të vaksinuarve në administratën shtetërore dhe publike, si dhe të përcaktojnë mundësitë për stimulimin e një numri sa më të madh të të vaksinuarve, si dhe bazën ligjore për kufizimet në të drejtën e kujdestarive, orët shtesë të punës, udhëtimet e punës dhe opsione të tjera për të ardhura shtesë për punonjësit e administratës publike<sup>2</sup>.</li> <li>Më 7 dhjetor 2021 Qeveria miratoi Strategjinë për Shëndetësi 2021-2030 me Plan veprimi<sup>3</sup>.</li> <li>Më 14 shkurt 2022 filloi skringing-testimi për Kovid-19 për të vlerësuar imunitetin e popullatës.</li> <li>Në bazë të konkluzionit të Komisionit për Sëmundjet Infektive në mbledhjen e mbajtur më 15 shkurt 2022, në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë janë publikuar Rekomandimet për trajtimin e pacientëve me Kovid-19.</li> <li>Nga data 8 shkurt 2022, Qeveria solli vendimin që vendimet për izolim të mund të shkarkohen në formë elektronike në ueb faqen <a href="https://vakcinacija.mk/mk/landing">https://vakcinacija.mk/mk/landing</a> me mbrojtje të privatësisë. Paraprakisht Komisioni i ri i Sëmundjeve Infektive, me qëllim rritjen e transparencës së personave që janë të izoluar për shkak të kontaktit me një person pozitiv ose kanë një test pozitiv të Kovid-19, si një masë të re, kishte propozuar publikimin e emrave dhe mbiemrave të tyre. Ndaj këtij propozimi reagoi Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi me mendimin se ky veprim cenon privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</li> </ul>	

<sup>1</sup> <http://zdravstvo.gov.mk/komisijata-za-zarazni-bolesti-nadgradena-so-novi-chlenovi-petlichkovski-naznachen-za-nov-pretsedatel-mehmedovikj-za-portparol/>

<sup>2</sup> Nuk ekziston asnjë informacion nëse një skringing i tillë është kryer në ministri, ndërmarrje publike, shoqëri aksionare dhe agjenci shtetërore për të përcaktuar përqindjen e të vaksinuarve në administratën shtetërore dhe publike. Në rast se është kryer, rezultatet nuk janë prezantuar në seancën e Qeverisë e as nuk janë bërë publikisht të disponueshme.

<sup>3</sup> Nuk dihet arsyeja e pse rekomandimet për trajtimin e Kovid-19 janë publikuar në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë me vonesë - në shkurt 2022, kur vetë dokumenti mund të konstatohet se është përgatitur në gusht 2021.

<p><b>Qasja, përpikmëria kohore dhe kuptueshmëria e vendimeve dhe informacioneve të tjera në lidhje me KOVID-19</b></p>	<p>Vendimet e Qeverisë dhe ministrive tjera relevante, lidhur me ushtrimin e të drejtës për shëndet dhe kujdes shëndetësor ishin në dispozicion të qytetarëve. Në uebfaqen <a href="https://koronavirus.gov.mk/">https://koronavirus.gov.mk/</a> janë publikuar informacione lidhur me Kovid-19, po megjithatë, mund të vihet re se ueb faqja nuk është përditësuar në pjesët që lidhen me përbërjen e re të Komisionit për Sëmundjet Infektive dhe Shtabit të Përgjithshëm Koordinues dhe nuk janë vendosur seancat e Qeverisë duke filluar nga viti 2022. Përbërja e re e Komisionit për Sëmundjet Infektive është publikuar në faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.</p>
<p><b>Informacion mbi mjetet që ndahen nga Buxheti i shtetit</b></p>	<p>Më 30 nëntor 2021, Qeveria në një seancë miratoi Projektligjin për mbështetje financiare për zvogëlimin e pasojave të shkaktuara nga Kovid-19 në prodhimin dhe blerjen e produkteve bujqësore.</p> <p>Në të njëjtën seancë, Qeveria ka miratuar Vendim për shpërblim të njëhershëm financiar në shumë prej 30 denarëve/pacient për mjekët e familjes nëse arrijnë dhe tejkalojnë mbulimin prej 70% të vaksinuarve nga numri i përgjithshëm i pacientëve të regjistruar.</p>

# B)

## E DREJTA PËR ARSIM



**D**etyrimi për të realizuar të drejtën për arsim vjen me detyrimin për të ndaluar diskriminimin mbi disa baza, duke përfshirë pozitën ekonomike dhe sociale dhe aftësitë e kufizuara, që janë kategoria më e ndikuar gjatë një pandemie. Mënyrat alternative të realizimit të procesit edukativ-arsimor (nëpërmjet mësimin në distancë duke përdorur mjete teknologjike) theksojnë edhe më tej pabarazitë që ekzistojnë mes nxënësve, por edhe vënë në pikëpyetje cilësinë e arsimit. Zbatimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në procesin arsimor synon t'i vërë në pah dobësitë e mësipërme për të parashikuar masa që do të jenë gjithëpërfshirëse në raport me dy palët më të ndikuara në procesin arsimor - nxënësit dhe mësimdhënësit.

Në këtë periudhë raportimi, nuk është vënë re një numër i konsiderueshëm i masave lidhur me procesin arsimor. Janë konstatuar ndryshime dhe shtesa në protokolle lidhur me realizimin e procesit arsimor në shkollat fillore dhe të mesme



si dhe përshtatja e planprogrameve për nxënësit për shkak të pushimit të zgjatur dimëror dhe për shkak të fillimit të gjysmëvjetorit të dytë më 1 shkurt 2022.

<b>TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E INSTITUCIONEVE LIDHUR ME KUFIZIMIN E TË DREJTËS PËR ARSIM.</b>		
<b>Llojet e publikimeve dhe institucioni që i miraton ato</b>	Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut	Komunikatat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës
Janë miratuar 6 vendime të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga 1 shtatori 2021 deri më 28 shkurt 2022, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e procesit arsimor në kopshtet, shkollat fillore dhe të mesme, si dhe në institucionet e arsimit të lartë.		
<b>Informacione të tjera të publikuara lidhur me realizimin e procesit arsimor</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Më 13 tetor 2021, Qeveria miratoi ndryshimet në Protokollin për realizimin e procesit arsimor<sup>4</sup> dhe arriti në përfundimin se fëmijët me nevoja të veçanta ose me aftësi të kufizuara në zhvillim mund të lirohen nga detyrimi për të mbajtur maskë në shkolla nëse paraqesin certifikatë mjekësore për gjendjen e tyre.</li> <li>Qeveria më 17 janar 2022 ka marrë Vendim për shtyrjen e fillimit të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor për shkollat fillore dhe të mesme, gjegjësisht vazhdimin e mësimin me prezencë fizike më 1 shkurt.</li> <li>11 shkolla (shtatë shkolla të mesme dhe katër fillore) filluan gjysmëvjetorin e dytë me mësim online për shkak të rinovimit të objekteve.</li> <li>Më 17 shkurt 2022, Komisioni i Sëmundjeve Infektive vendosi të bëjë skrining në shkollat fillore pasi raporti i fundit i Institutit të Shëndetit Publik rriti numrin e fëmijëve të infektuar në shkollat fillore. Për testimin e nxënësve, nevojitet pëlqimi i prindërve.</li> </ul>	
<b>Qasja, përpikmëria kohore dhe kuptueshmëria e vendimeve dhe informacioneve të tjera në lidhje me COVID-19</b>	Vendimet e Qeverisë dhe informacionet e publikuara të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, lidhur me realizimin e të drejtës në arsim ishin të disponueshme për qytetarët. Protokollat lidhur me procesin arsimor janë publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe në <a href="https://koronavirus.gov.mk/">https://koronavirus.gov.mk/</a>	

<sup>4</sup> Për shkak se në Procesverbalin e seancës së 112-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk është shënuar emri i plotë i Protokollit, nga shqyrtimi i protokolleve të publikuara në ueb faqen <https://koronavirus.gov.mk/> mund të konstatohet se bëhet fjalë për ndryshime të protokolleve në vijim: Protokollin për veprimin e shkollave fillore në Republikën e Maqedonisë së Veriut në raport me realizimin e procesit edukativ-arsimor me prezencë fizike të nxënësve për vitin shkollor 2021/2022 dhe Protokollin për veprimin e shkollave të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut në raport me realizimin e procesin arsimor me prezencë fizike të nxënësve për vitin akademik 2021/2022.

Me qëllim që të analizohet zbatimi i mësimi në distancë në vitin akademik 2020/2021, Instituti për të Drejtat e Njeriut ka realizuar një anketë, e cila përmes zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut kishte për synim të përcaktojë sfidat me të cilat ballafaqohen mësimdhënësit dhe nxënësit në procesin mësimor në distancë gjatë vitit akademik 2020/2021. Njëkohësisht, u dha mundësinë që të shprehin mendimin e tyre në lidhje me cilësinë e nxënies, por edhe të ofrojnë vullnetarisht dhe në mënyrë anonime mundësi për përmirësimin e arsimit, gjë nga e cila do të përfitojnë të dyja palët ndikuara - mësimdhënësit dhe studentët. .

Mësimi me prezencë fizike nuk mund të zëvendësohet kurrë nga mësimi në distancë, kjo gjë vërtetohet nga përvoja e mësimdhënësve dhe nxënësve. Nëse e kërkon gjendja shëndetësore, nxënësit do të zgjidhnin mësimin në distancë për të mbrojtur shëndetin e tyre si dhe të nxënësve dhe mësuesve të tjerë dhe për të shmangur detyrimin e mbajtjes së maskave mbrojtëse për disa orë.

Bashkangjitur janë konkluzionet dhe rekomandimet nga përgjigjet e nxënësve dhe mësimdhënësve për përmirësimin e procesit arsimor në të ardhmen.

<b>KONKLUZIONE NGA NXËNËSIT</b>	
<b>Mungesa e pajisjeve të duhura elektronike</b>	Nxënësit janë ankuar për mungesën e pajisjeve adekuate për ndjekjen e mësimi, gjegjësisht për mungesën e një pajisje personale (kompjuter, tablet apo laptop) si dhe për mungesën e internetit.
<b>Mbështetja psikologjike për nxënësit</b>	Hulumtimet kanë treguar se shumë nxënës përballen me dëmtim të shëndetit mendor, izolim social dhe distancim nga shokët e tjerë të klasës. Mbështetja psikologjike në shkolla nuk u është prezantuar siç duhet nxënësve.  Disa nxënës kanë preferuar mësimin në distancë sepse janë përballur me dhunë nga bashkëmoshatarët (bullying).
<b>KONKLUZIONE NGA MËSIMDHËNËSIT</b>	
<b>Përshtatja e programit mësimor</b>	Mësuesit rekomandojnë se nevojitet një përshtatje e programit mësimor, reduktim i fondit të orëve me qëllim fokusimin mbi efektivitetin dhe mirëqenien e nxënësve.  Është e nevojshme të rritet numri i orëve ku nxënësit do të bisedojnë me kujdestarin e klasës, psikologun dhe pedagogun.
<b>Organizimi i trajnimeve dhe materiale shtesë</b>	Mësuesit rekomandojnë se nevojitet të mbahen trajnime për vlerësimin me notë gjatë mësimdhënies në distancë, të ketë qasje më të madhe ndaj video materialeve, përmbajtjeve elektronike dhe online librave.  Nevojë për krijimin e një rrjeti të mësimdhënësve që japin të njëjtat lëndë në shkolla të ndryshme me qëllim ndarjen e praktikave dhe eksperiencave të mira.

**Rekomandimet për tejkalimin e problemeve gjatë realizimit të procesit arsimor, në rast se në të ardhmen vazhdon mësimi në distancë, janë këto:**

- Zhvillimi i sistemeve që do t'u ndihmojnë shkollave të reduktojnë dhe/ose të zhdukin dhunën e bashkëmoshatarëve dhe të rrisin ndërgjegjësimin për pasojat e saj;
- Përfshirja e të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë në procesin edukativ-arsimor duke siguruar pajisje elektronike dhe karta të internetit me qëllim që të realizohet mësim në distancë pa pengesa, veçanërisht për nxënësit që vijnë nga familjet me më shumë fëmijë, nga ato në rrezik social dhe nga grupet e marginalizuara të qytetarëve;
- Krijimi i materialeve që janë të aksesueshme në mënyrë elektronike dhe të lehta për t'u kuptuar. Materiali mësimor dhe mësimet e dhëna nga mësuesit të jenë ndërvepruese dhe lehtësisht të kuptueshme nga nxënësit;
- Trajnime të duhura për mësime dhënësit në mënyrë që të përdorin mjetet në mënyrë më efektive dhe më lehtë të mbajnë kontroll gjatë orëve të mësimi;
- Një numër i konsiderueshëm mësuesish janë të mendimit se mësimi në distancë ka ndikuar në cilësinë e arsimit për disa arsye, ndër të cilat theksohet nevoja për përfshirje më të madhe të prindërve, të cilët duhet t'i inkurajojnë fëmijët e tyre që ta marrin seriozisht mësimin në distancë.

# C)

## ZBATIMI I QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT NË STRATEGJI, POLITIKA DHE DOKUMENTE TË TJERA QË KANË TË BËJNË ME TË DREJTËN PËR SHËNDET DHE KUJDES SHËNDETËSOR GJATË KOHËS SË KOVID-19.



**A**naliza shtesë për masat në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe analiza krahasuese për nxitjen e vaksinimit.

Më 25 nëntor 2021 Qeveria në një seancë rekomandoi që të bëhen analiza shtesë të masave në vend, si dhe analiza krahasuese me vendet e tjera me qëllim përmirësimin dhe fuqizimin e masave ekzistuese, si dhe propozimin e masave, mekanizmave dhe instrumenteve të tjera për nxitjen e vaksinimit. Deri më tani nuk është publikuar asnjë informacion nëse këto analiza dhe masa janë përgatitur dhe nëse janë të disponueshme për publikun, apo arsytet se pse ato nuk janë përgatitur dhe/ose publikuar deri më tani.

## **Strategjia për shëndetësi e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2030 me Plan veprimi**

Strategjia e shëndetësisë 2021-2030 është miratuar në dhjetor 2021. Me Strategjinë për shëndetësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2030 jepet drejtimi dhe përcaktohen rrugët për modernizimin dhe zhvillimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut me qëllim përmirësimin e gjendjes shëndetësore të popullsisë dhe përmirësimin e përvojës me kujdesin shëndetësor për çdo qytetar<sup>5</sup>. Në prioritetet strategjike, konkretisht qëllimi 11 i referohet gatishmërisë së sistemit shëndetësor dhe burimeve për menaxhimin e mëtejshëm të Kovid-19, si dhe zhvillimit dhe vendosjes praktike të planeve dhe aktiviteteve në rast të situatave të paparashikuara në betejën kundër pandemieve të ardhshme.

Si pjesë e realizimit të këtij qëllimi është planifikuar që të kryhet një vlerësim i nevojës për çfardollos plani konkret shërbimi lidhur me trajtimin e efekteve dhe pasojave afatgjata të pacientëve me KOVID-19 “afatgjatë” si dhe vlerësimi i nivelit të planifikimit, përgatitjes dhe financimit të “rezervës” për një pandemi potenciale në të ardhmen. Mësimet e fituara nga vlerësimi i përballimit të pandemisë Kovid-19 duhet të zhvillohen më tej. Vlerësimet që kanë të bëjnë me përgatitjen e planeve konkrete për trajtimin e pasojave afatgjata të pandemisë, si dhe vlerësimi dhe përgatitja për një pandemi të mundshme në të ardhmen duhet të bëhen sa më shpejt që të jetë e mundur këtë vit, në mënyrë që sistemi shëndetësor të jetë gati për një pandemi potenciale në të ardhmen, por edhe për të analizuar masat e marra, mënyrën e trajtimit dhe pasojat e pandemisë aktuale, të shkaktuar nga Kovid-19. Gjithashtu, krijimi i një njësie për planifikim strategjik, mes tjerash, edhe në fushën e epidemiologjisë, nevojitet të realizohet sa më shpejt që të jetë e mundur, ngaqë pandemia është ende në proces dhe ka efekte të konsiderueshme në sistemin shëndetësor dhe në radhë të parë të qytetarëve<sup>6</sup>.

---

5 Strategjia për shëndet e Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2030, <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2021/12/19.11.-SZ-posledna-Konechna-Natsrt-Strategjia-MKD.pdf>

6 Në qëllimin strategjik 1 të Strategjisë për shëndet 2021-2030 parashikohet që Ministria e shëndetit të krijojë, brenda institucioneve ekzistuese, një njësi për planifikimin strategjik, stafi i së cilës duhet të ketë një nivel të lartë ekspertize (ose të kalojë një proces të veçantë zhvillimi) për planifikimin strategjik të një sistemi shëndetësor, epidemiologjisë, kujdesit shëndetësor të bazuar në dëshmi, PZT, menaxhimit me efikasitetin e ekonomisë shëndetësore, monitorimit dhe vlerësimin të sistemit shëndetësor).



# KONKLUZIONE NGA ZBATIMI I DERITANISHËM I QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT GJATË KRIZËS SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

**P**olitikat shëndetësore të cilat zbatohen gjatë pandemisë aktuale të shkaktuar nga Kovid-19 duhet të jenë proporcionale, të justifikuar dhe të miratohen në bazë të hulumtimeve të mëparshme dhe strategjive të përgatitura.

Rezultatet e skringut të popullatës me qëllim vlerësimin e imunitetit të popullatës si dhe skringu në shkollat fillore duhet të jenë baza për përgatitjen e analizave gjithëpërfshirëse në drejtim të nxitjes së procesit të vaksinimit, por edhe për të dhënë një pasqyrë të detajuar të përqindjes së rasteve pozitive të Kovid-19 në shkollat fillore si dhe masat mbrojtëse që do të ndërmerren për parandalimin e transmetimit të virusit. Nëse analizohen masat e marra, mund të konstatohet se ato janë të domosdoshme dhe proporcionale. Megjithatë, gjatë krijimit të politikave dhe marrjes së vendimeve nuk merren parasysh kushtet specifike në të cilat ndodhen personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët dhe veçanërisht viktimat e dhunës në familje dhe me bazë gjinore. Përveç dokumenteve dhe analizave të përgatitura të organizatave të shoqërisë civile që kanë të bëjnë me menaxhimin e krizës shëndetësore nga aspekti i grupeve të marginalizuara, personave me aftësi të kufizuara, viktimave të dhunës në familje dhe

në bazë gjinore, Qeveria apo më saktë Ministria e Shëndetësisë nuk kanë përgatitur analiza për ndikimin e pandemisë mbi sistemin shëndetësor në përgjithësi, apo edhe mbi grupe të caktuara të qytetarëve të cilët janë më të ndikueshëm nga ana shëndetësore. Gjithashtu, vihet re mungesa e planeve apo programeve të përgatitura që do të trajtojnë reduktimin e efekteve negative të Kovid-19 tek personat me aftësi të kufizuara.

Është e nevojshme t'i kushtohet më shumë rëndësi zbatimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në lidhje me këto kategori të qytetarëve sa i përket realizimit të së drejtës për shëndet dhe kujdes shëndetësor në kushtet e pandemisë globale, duke respektuar parimet e transparencës, llogaridhënies, mosdiskriminimit dhe pjesëmarrjes. Qëllimet strategjike në Strategjinë Shëndetësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2030 të cilat i referohen vlerësimit të nevojës për çfardolloj plani konkret shërbimi lidhur me trajtimin e efekteve dhe pasojave afatgjata te pacientët me KOVID-19 “afatgjatë” si dhe vlerësim i nivelit të planifikimit, përgatitjes dhe financimit të “rezervës” për një pandemi potenciale në të ardhmen duhet të përgatitet sa më shpejt që të jetë e mundur. E gjithë kjo në mënyrë që të mos përsëriten gabimet e së shkuarës, por edhe që kujdesi shëndetësor të jetë i gatshëm të veprojë në mënyrë efikase në rastin e një pandemie në të ardhmen.

